

RAPORT MONITORIMI

Biblioteka Kombëtare

Gusht-Tetor 2020

**BIBLIOTEKA
KOMBETARE**

AUTOR
Erisa Kryeziu

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy

Supporting Freedom and the Rule of Law

www.qeverisja.qq.com.al

100 vjet Bibliotekë Kombëtare

Në 10 korrik të vitit 1920 u themelua Biblioteka Kombëtare Shqiptare si institucioni i parë shtetëror, publik dhe laik, ndonëse tradita dhe pasuria librare është me e vjetër se ky institucion, duke nisur që në Mesjetë e duke u pasuruar ndër shekuj përmes zhvillimeve historike.

Për krijimin e Bibliotekës Kombëtare si institucion i parë shtetëror, shërbeu fondi i bibliotekës së 'Komisës Letrare Shqipe', organizëm i përbashkët shqiptaro-austriak, i krijuar në qytetin e Shkodrës më 1917. Më vonë, ky fond u vendos në Ministrinë e Arsimit në Tiranë, për t'u pasuruar në vijim deri në riorganizimin e tij si një institucion më vete.



Sipas të dhënave¹ të Bibliotekës, në vitet 1922 ajo kishte 6000 vëllime, ndërsa mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Bibliotekën me 15 000 vëllime.

Më 1966 Biblioteka Kombëtare u vendos në një ndërtesë të re të asaj kohe, në Pallatin e Kulturës, ku gjendet edhe sot.

¹ https://www.bksh.al/rreth_nesh/historiku



BIBLIOTEKA KOMBËTARE “PREMTIMI KURBAN” I ÇDO POLITIKANI



“Akoma është dera me projekturë alumini prej kohës së komunizmit, asnjë institucioni në Shqipëri s’i ka mbetur. Është një institucion, të cilit i është rënë në qafë. Mjafton të hysh këtu, hyrja është depresive” (Piro Misha, drejtuesi aktual i Bibliotekës Kombëtare)

Që prej vendosjes në godinën ku ndodhet edhe sot, Biblioteka Kombëtare nuk e ka ndryshuar vendodhjen e saj, e si rrjedhim edhe kapacitetet në hapësira për librat dhe pasuritë e shkruara kanë qenë të njëjta, përpos rritjes së numrit të veprave dhe fondeve të saj.

Kjo problematikë ka bërë që Biblioteka Kombëtare të jetë një ndër temat më të përfolura në diskutet politike në formën e një premtimi të vazhdueshëm për planin e një Biblioteke të re Kombëtare.

Në dhjetor të 2013, Ministrja e atëhershme, e Kulturës, Mirela Kumbaro ngriti shqetësimin për gjendjen në të cilën ndodhej Biblioteka dhe nevojën për ndërhyrje të menjëhershme.



2“Gjendja në Bibliotekën Kombëtare është skandaloze. Kërkohet ndërhyrje urgjente për krijimin e hapësirave të reja”, -u shpreh Kumbaro, teksa theksoi se tanimë nuk flitej më për rafte, por për male me libra.

Në 95 vjetorin e themelimit të Bibliotekës Kombëtare, drejtoresha e saj në atë kohë, Persida Asllani nënvizoi sërish nevojën për një bibliotekë më dinjitoze.



3“Unë kam një ëndërr, [...] për një bibliotekë të përtërirë, dinjitoze, jo vetëm për mënyrën si funksionon në informacionin dhe pasurinë që i ofron kulturës kombëtare, por dinjitoze dhe në hapësirat e veta, në mjediset e punës dhe të leximit,” u shpreh Asllani.

² <http://www.panorama.com.al/buxheti-2014-pollo-kumbaro-ministre-kursimtare/>

³ <https://exit.al/premtimet-e-pambajtura-te-kryeministrit-rama-per-biblioteken-kombetare/>

Me një ton më të sigurt dhe vendimmarrës u shpreh Kryeministri Edi Rama, në po të njëjtin përvjetor të Bibliotekës, teksa e vendosi si qëllim të qeverisjes së tij shndërrimin e Bibliotekës në një investim strategjik.



4“Unë dua vetëm që t’ju siguroj të gjithëve se ne do të bëjmë për Bibliotekën Kombëtare sa nuk është bërë në 25 vjet të marra së bashku, me bindjen që ky është një investim me një rëndësi strategjike për vendin tonë, për shoqërinë tonë, dhe jo thjesht për komunitetin e njerëzve që e vizitojnë Bibliotekën Kombëtare apo që e shfrytëzojnë kapitalin e saj të madh, sepse procesi i rrezatimit bën që ajo çka jetohet në përditshmërinë e Bibliotekës Kombëtare të shkojë shumë më larg sesa rrethi i njerëzve që janë drejtpërdrejtë të lidhur me këtë veprimtari”,- u shpreh Kryeministri Rama në vitin 2015.

Megjithatë edhe pas pesë vitesh qeverisje, sërish në diskursin publik, kulturor dhe politik biblioteka qëndron si “një nga dëshirat” e çdo drejtuesi të saj, ministri të kulturës dhe ende e Kryeministrit.

Në ekspozitën e librave të rrallë të mbajtur në qendrën Hapje dhe Dialog, në 100 vjetorin e Bibliotekës Kombëtare Kryeministri Rama u shpreh se do të ishte më bukur që ky 100 vjetor i themelimit të Bibliotekës ti kishte gjetur në një bibliotekë të re.

5“Do të kishte qenë vërtet shumë më bukur sikur ne të kishim mundësinë që këtë 100 vjetor ta kremtonim në godinën e Bibliotekës së Re kombëtare që është një domosdoshmëri e kahershme tanimë, por fatkeqësisht projekti i nisur me shumë dëshirë edhe i futur në procesin e formësimit të tij, mbase gaboj por kam përshtypje që duhet të jetë Persida ajo me të cilën kemi punuar sistematikisht për ta futur në rrugë projektin, u desh të ndalej nga tërmeti dhe mbetet i ndalur edhe sot, pasi rrënojave të tërmetit që duhen kthyer në mijëra shtëpi, në mijëra apartamente iu mbivendos edhe goditja e rëndë financiare e të gjithëve për shkak të COVID-it”,- ceku në fjalën e tij Kryeministri Rama.

Edhe pas premtimit të një godine të re dhe të denjë në 95 vjetorin e themelimit të saj, akoma projekti i një Biblioteke të re Kombëtare qëndron një ëndërr dhe një sfidë e Ministres së sotme të Kulturës, Elva Margariti.

⁴ <https://kryeministria.al/newsroom/vemendje-dhe-mbeshtetje-per-kulturen/>

⁵ <https://www.facebook.com/edirama.al/videos/464956804877599>



“Hapi i parë që ne kemi menduar është shfryrja drejt Fondit, por projekti madhor ngel gjithmonë projekti i Bibliotekës së re Kombëtare. Për këta tashmë me Bashkinë e Tiranës kemi marrë tashmë një hap konkret dhe kemi përcaktuar një zonë ku do të jetë zona ku do të krijohet një poli i kulturor, ku biblioteka është qendra e këtij poli. Nuk jemi ende në fazë në miratimit të disa buxheteve pasi projekti ende nuk ka përfunduar”, - u shpreh Margariti në një dalje mediatike.



⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=RcJKdPvg5Hg>



BIBLIOTEKA KOMBËTARE “E PA STREHA” VIGJILENTE NDAJ ZJARRIT DHE PËRMBYTJES

Mungesa e investimeve afatgjata ose jo, të kryera pranë godinës së Bibliotekës Kombëtare si dhe projektet e reja infrastrukturore të ndërtuara përkrah saj pa marrë në konsideratë harmoninë infrastrukturore me bibliotekën, bënë që përgjatë viteve të fundit Biblioteka të përjetojë “gjendje paniku” të herëpashershme, të shoqëruara edhe më dëme të konsiderueshme materiale e monetare.

Më 15 mars të vitit 2017, në orën 10:40 të mëngjesit në katin e dytë të fondeve të bibliotekës shpërtheu një zjarr që shkaktoi dëme të konsiderueshme, megjithëse u deklarua nga drejtuesit e saj se nuk janë prekur vlerat e rralla dhe se botimet e përfshira nga flakët i përkasin pas viteve '90.

Në një kërkesë dërguar Bibliotekës Kombëtare, na saktësohet se dëmi i shkaktuar nga zjarri i vitit 2017 kap një numër prej 73308 njësive bibliotekare, të cilat në total përbëjnë një dëm monetar prej 1.265.200 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë. (102248 euro).

Të ndara sipas kategorive librat e asgjesuar i përkasin:

Numri i njësive bibliotekare	Fondi	Vlera monetare
748 njësi bibliotekare	fondi i koleksioneve të gazetave	18700 lekë; (151 euro)
273 njësi bibliotekare	fondi i koleksioneve të revistave	163.800 lekë (1.32348 euro)
134 njësi bibliotekare	fondi i librit të huaj/fjalorë	53600 lekë; (433 euro)
100 njësi bibliotekare	fondi i librit të huaj	
2053 njësi bibliotekare	fondi i librit shqip	1026500 lekë (8294 euro)

⁷ Të dhëna të përfuturara nga kërkesat për informacion drejtuar Bibliotekës Kombëtare

Më 22 qershor të vitit 2018, një vit pas djegies së 3308 njësive bibliotekare, në një nga sallat e nëndheshme të Bibliotekës Kombëtare vërshoi uji pas rreshjeve të shiut gjatë ditës.

Megjithëse ngjarja ndodhi të shtunën, lajmi u bë publik të hënën, ndërsa biblioteka njoftoi se librat e prekur nga uji i përkisnin kryesisht botimeve shkollore dhe teksteve të 15 viteve të fundit.⁸Në media u bë publike se ishin dëmtuar rreth 12 mijë libra, revista dhe gazeta, të cilat kaluan më pas në proces tharjeje.

Sipas përgjigjes së Bibliotekës ndaj kërkesës për informacion në lidhje me dëmin e shkaktuar nga uji i futur në ambientet e nëndheshme të saj, nuk ka pasur asnjë njësi bibliotekare të dëmtuar të parikuperueshme, e për rrjedhojë nuk ka pasur as dëm ekonomik. Sipas Bibliotekës njësitë e lagura po trajtohen me protokollat përkatëse tekniko-profesionale dhe se ky proces restaurimi vazhdon edhe sot, dy vjet pas ngjarjes.

Në relacionin teknik të mbajtur nga Insituti i Ndërtimit pas përmbytjes së Bibliotekës theksohet qartë nevoja për ndërhyrje dhe mungesa e hapësirave.

“Gjendja e instalimeve elektrike, te rrymave te dobta dhe te sistemeve te sigurise ne godinen e Bibliotekes le shume per te deshiruar, ajo nuk permbush kerkesat teknike, normat dhe standartet per aplikimin e tyre ne nje godine te kategorise se vecante, nuk ofrojne garanci dhe siguri per funksionimin e tyre. Keshtu nje rikonstruksion sa me i shpejte me nje projekt te miredetajuar ne pershtatje me te gjithe normat, standartet dhe rregullat e instalimit eshte i domosdoshem per mbarevajtjen dhe sigurine ne objekt”, - thuhet në relacionin teknik të Insitutit të Ndërtimit.

Ndër të tjera në relacion theksohet se mungesa e hapësirave ka bërë që të krijohen raftet “imagjinare”, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e librave përgjatë korridoreve dhe shkallëve të kateve në bodrum, duke penguar lëvizjen e lirë, por edhe duke krijuar bllokim për raste emergjente si tërmet, zjarr apo përmbytje.

⁸ <https://www.reporter.al/biblioteka-kombetare-shpall-emergjencen-pas-vershimit-te-ujit-ne-ambientet-e-nendheshme/>

⁹ <http://www.institutindertimit.al/sites/default/files/Relacion%20p%C3%ABr%20Bibliotek%C3%ABn%20Komb%C3%ABtare.0.pdf>





SIGURIA E GODINËS ME ROJE PRIVATE, E VETMJA GJURMË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE NË PROKURIMET PUBLIKE

Institucioni i Bibliotekës Kombëtare mbart një rëndësi të veçantë kulturore dhe të identitetit të një vendi. Mirëpo, sikurse edhe nga parashtrimet e më sipërme investimet në këtë institucion në periudhën e demokracisë kanë qenë inekzistente.

¹⁰“Hapësirat në funksion të saj kanë më shumë se 20 vjet që nuk i plotëson nevojat e saj. Kjo ndërtesë konsiderohet “provizore”, sepse ajo ka qënë e destinuar për të qënë Bibliotekë e qytetit të Tiranës”. (relacioni teknik i Institutit të Ndërtimit).

Megjithëse, është një insitucion i varur nga Ministria e Kulturës dhe si e tillë edhe financimet vijnë prej kësaj ministrie, sërish proceset e prokurimit janë të pakta për këtë institucion. Madje mund të themi se të shumtat i përkasin vetëm një drejtimi, atij të mbrojtjes dhe sigurisë së godinës përmes rojeve private.

Në një vëzhgim të kryer në regjistrin e buletinëve të prokurimeve publike për vitet 2017-2018-2019-2020 vihet re se pjesën më të madhe të thirrjeve, shpalljeve të fituesve dhe nënshkrimeve të kontratave e zënë firmat e sigurive të godinave.

- Kështu për vitin 2017 ka gjithsej **6 thirrje/shpallje** nga Biblioteka Kombëtare, ku të gjitha i përkasin karakterit të sigurisë së godinës.
- Në vitin 2018 ka **7 thirrje/shpallje** për shërbim me roje private për dy godinat e bibliotekës, **2 njoftime ankandi/shpallje fituesi** për shitjen e materialeve bibliotekare të vjetëruara për riciklim letre, si dhe **3 thirrje/shpallje për rikonstruksionin** (punime elektrike/mekanike/ndërtimi) të sallës 300 të fondit (katet e nëndheshme) të Bibliotekës kombëtare.

¹⁰http://www.institutindertimit.al/sites/default/files/Relacion%20p%C3%ABr%20Bibliotek%C3%ABn%20Komb%C3%ABtare._0.pdf

- Në vitin 2019 ka gjithsej **7 thirrje/shpallje** për shërbim me roje private për të dy godinat e bibliotekës, ndërsa në vitin 2020 ka vetëm **një thirrje** për shërbim roje private për të dy godinat.

Referuar thirrjeve/shpalljeve nga ana e Ministrisë së Kulturës për Bibliotekën Kombëtare në vitin 2020 ka **dy thirrje/ shpallje** për Biblioteka Kombëtare që kanë të bëjnë kryesisht me rikonstruksionin e rrjetit elektrik të sallës 300 të fondeve si dhe rikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (Fondi i Bibliotekës Kombëtare), ndërsa përgjatë viteve 2017, 2018, 2019 nuk ka asnjë shpallje apo thirrje për shërbim.

E parë kjo në tërësi, vetëm për shërbimin e rojeve private për sigurimin e dy godinave, atë të Bibliotekës Kombëtare dhe atë të fondit të Bibliotekës Kombëtare (me adresë në rrugën e Elbasanit), ka gjithsej **21 thirrje/shpallje** fituesi përgjatë katër viteve të fundit, nga 28 në total.



“NGA 10 LEKË, 8 SHKOJNË PËR PAGA DHE SIGURIME PUNONJËSISHT”

Deri më tani Biblioteka Kombëtare nuk ka kryer asnjë procedurë prokurimi për rikonstruksionin e godinës. Në ato raste kur ka ndërhyrë, kanë qenë kryesisht pas dëmeve të shaktuara nga zjarri dhe nga përmytja.¹¹ Sipas Bibliotekës Kombëtare në vitin 2017 Buxheti i Shtetit ka akorduar fondin:

-Blerje pajisje shtesë në fushën e mbrojtjes nga zjarri (fikse zjarri automatike dhe sistem të diktimit sinjalizimit të zjarrit dhe impiantit hidrik) në vlerën 2.208.040 lekë, në sallat e fondit përfshirë dhe sallën ku ka rënë zjarri.

-Në vitin 2018 Buxheti i Shtetit ka akorduar fondin prej 1.555.600 lekë për masat që duhen marrë për eliminimin e pasojave që mund të vijë nga ndonjë ngjarje e fillë e mundshme në të ardhmen, kryesisht në sallën 300 të fondeve, ku ndodhi dhe përmytja.

Ndërsa për vitin 2020, sipas Bibliotekës Kombëtare është akorduar fondi prej 2.400.000 lekësh për rikonstruksionin e rrjetit elektrik të sallës P-300 (fondi i BKSH), i cili është në proces realizimi.

¹¹ Të dhëna të përftuara përmes kërkesa për informacion

Nëse do të analizojmë buxhetet e institucionit të Bibliotekës Kombëtare që prej vitit 2016 dhe deri më sot, do të kuptojmë se ku shpërndahen më së shumti zërat e buxhetit dhe për çfarë shpenzon më shumë Biblioteka.

Përkatësisht, buxheti i vitit 2016 ka qenë në shifrën **92.300.735. (745,329 euro)**

Buxheti i vitit 2017 ka qenë në shifrën **103.775.899 lek (837 905 euro)**

Buxheti i vitit 2018 ka qenë në shifrën **102.458.523 lek (827 272 euro)**

Buxheti i vitit 2019 ka qenë në shifrën **99.010.838 lek (799 907 euro)**

Buxheti i vitit 2020 ka qenë në shifrën **100.239.000 lek (809 836 euro)**

Ajo çka vihet re është se ka një luhatje të lehtë të buxheteve ndër vite, duke shënuar shifrën më të lartë në vitin 2017.

Por si janë shpërndarë paratë e buxheteve ndër vite?

Buxheti i vitit 2016:

Nr.	Artikujt e Buxhetit	Vlera Lekë
1	Atrikulli 600 (paga personeli)	66.024.000
2	Artikulli 601 (sigurime shoqërore, shëndetësore)	11.015.000
3	Artikulli 602 (shpenzime operative)	12.900.000
4	Artikulli 604 (projekte kulturore)	1.000.000
5	Artikulli 605 (kuotizacione në org. ndërkombëtare)	600.000
6	Artikulli 606 (të tjera transferata tek individët)	761.735
	Totali i buxheti për vitin 2016	92.300.735

Buxheti i vitit 2017 :

Nr.	Artikujt e Buxhetit	Vlera Lekë
1	Atrikulli 600 (paga personeli)	74.716.100
2	Artikulli 601 (sigurime shoqërore, shëndetësore)	12.395.100
3	Artikulli 602 (shpenzime operative)	13.171.503
4	Artikulli 604 (projekte kulturore)	800.000
5	Artikulli 605 (kuotizacione në org. ndërkombëtare)	368.497
6	Artikulli 606 (të tjera transferata tek individët)	72.300
7	Artikulli 231 (investime) (blerje paisje të sistemit të diktimit sinjalizimit të zjarrit dhe impjantit hidrik)	2.208.040
8	Artikulli 231 (investime) (blerje pajisje kompjuterike)	44.359
	Totali i buxheti për vitin 2017	103.775.899

Buxheti i vitit 2018:

Nr.	Artikujt e Buxhetit	Vlera Lekë
1	Atrikulli 600 (paga personeli)	73.750.000
2	Artikulli 601 (sigurime shoqërore, shëndetësore)	12.291.000
3	Artikulli 602 (shpenzime operative)	13.587.628
4	Artikulli 604 (projekte kulturore)	143.000
5	Artikulli 605 (kuotizacione në org. ndërkombëtare)	362.372
6	Artikulli 606 (të tjera transferata tek individët)	368.923
7	Artikulli 230 (studim projektim)	400.000
8	Artikulli 231 (rikonstruksione)	1.555.600
	Totali i buxheti për vitin 2018	102.458.523

Buxheti i vitit 2019:

Nr.	Artikujt e Buxhetit	Vlera Lekë
1	Atrikulli 600 (paga personeli)	70.752.797
2	Artikulli 601 (sigurime shoqërore, shëndetësore)	11.754.703
3	Artikulli 602 (shpenzime operative)	15.456.000
4	Artikulli 604 (projekte kulturore)	500.000
5	Artikulli 605 (kuotizacione në org. ndërkombëtare)	344.000
6	Artikulli 606 (të tjera transferata tek individët)	203.338
	Totali i buxheti për vitin 2019	99.010.838

Buxheti i vitit 2020:

Nr.	Artikujt e Buxhetit	Vlera Lekë
1	Atrikulli 600 (paga personeli)	71.980.000
2	Artikulli 601 (sigurime shoqërore, shëndetësore)	12.059.000
3	Artikulli 602 (shpenzime operative)	12.979.718
4	Artikulli 604 (projekte kulturore)	500.000
5	Artikulli 605 (kuotizacione në org. ndërkombëtare)	320.282
6	Artikulli 231 (Rikonstruksion i rrjetit elektrik të sallës P300 në fond).	2.400.000
	Totali i buxheti për vitin 2020	100.239.000

Pjesa më e madhe e buxheteve përgjatë katër viteve të fundit ka shkuar për paga për personelin, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nëse do të flisnim për çdo vit, zëri për paga dhe sigurime shkon në:

- Viti 2016: Nga **92.300.735** në total, **77,039,000** kanë shkuar për paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
- Viti 2017: Nga **103.775.899** në total, **87,111,200** kanë shkuar për paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
- Viti 2018: Nga **102.458.523** në total, **86,041,000** kanë shkuar për paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
- Viti 2019: Nga **99.010.838** në total, **82,507,500** kanë shkuar për paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
- Viti 2020: Nga **100,239,000** në total, **84,039,000** kanë shkuar për paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Pagat për personelin dhe sigurimet shoqërore/shëndetësore 2016-2020

Pjesën më të madhe të buxhetit të Bibliotekës Kombëtare e zenë pagat dhe sigurimet shoqërore/shëndetësore për punonjësit e saj.




Chart: Erisa Kryeziu • Source: Biblioteka Kombëtare • Created with Datawrapper

Shpenzimet për projektet kulturore kanë pasur nivelin e tyre më të lartë në vitin 2016 me 1.000.000 lek, për të pasur shifrën më të ulët në vitin 2018 me 143.000 lek, ndërsa për vitin 2020 kanë pasur vetëm 500.000 lek fond.

Vlen të theksohet se në vitin 2016 nuk ka pasur asnjë shpenzim në lidhje me rikonstruksionin apo riparime në godinë, ndërsa që prej vitit 2017 që lidhet edhe me rënien e zjarrit, ka pasur një fond të veçantë për blerje pajisjesh, për të përfunduar deri më sot, ku po investohet në rrjetin elektrik të sallës P300 ku pati edhe përmbytje.



DIGJITALIZIMI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE, E VETMJA MUNDËSI PËR TË AKSESUAR INFORMACION

Mes zjarreve, përmytjeve të ambienteve të Bibliotekës, mungesës së hapësirave, të shkaktuara nga mos investimi në këtë godinë dhe mos pasjen e një projekti të ri të Bibliotekës, shtuar së fundmi edhe pandemia e COVID-19, duket se e vetmja mënyrë për të pasur akses në dorëshkrime, libra, antikuarë e periodikë është marrja e tyre online.

Megjithëse, digjitalizimi është një proces që për vende të tjera evropiane ka nisur më herët, në Shqipëri për insitucionin e Bibliotekës Kombëtare sapo ka nisur dhe është në proces.

Sipas Bibliotekës, deri më tani janë digjituat 176 antikuarë, 234 dorëshkrime, 78 harta albanologjike, 119 tituj të periodikut shqip/revista, gazeta (koleksion i plote), 274 tituj librash, 50 bibliografi të librit shqip, 43 bibliografi të periodikut shqip.

Nëse do ta shohim në një panoramë përqindjesh, përkthehet në :

- 7% të antikuarëve,
- 19.5 % të dorëshkrimeve,
- 7,5 % të hartave albanologjike,
- 21.4 % e periodikut,
- 6.2 % e librit,
- 100 % bibliografia e librit shqip,
- 100% bibliografi e periodikut shqip

Parë në format grafiku rezulton në:

Digjitalizimi i Bibliotekës Kombëtare 2020

Digjitalizimi i pasurive të Bibliotekës Kombëtare deri më tani, shprehur në %




Chart: Erisa Kryeziu • Source: Biblioteka Kombëtare • Created with Datawrapper



BIBLIOTEKA KOMBËTARE SHQIPTARE PËRBALLË SIMOTRËS TË SAJ

Për të pasur një panoramë më të qartë se çfarë ndodh me bibliotekat e tjera kombëtare, nuk duhet të argohesh shumë nga Shqipëria. Mjafton të kalosh në Kosovë dhe kupton se kujdesi ndaj këtij insitucioni është më i lartë.

Biblioteka Kombëtare e Prishtinës është themeluar në Prizren më 1943, por është transferuar në Prishtinë kur u shpall kryeqytet i Kosovës.

Ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë ka një hapësirë prej 16.500 metra katror, ndërsa numëron dy kate nën tokë ku është vendosur arkivi me libra dhe katër kate mbi tokë.

Të gjitha këto hapësira sigurojnë edhe 400 vende për lexuesit që duan të frekuentojnë këtë bibliotekë, Ndërsa karakteristika tjetër që e mban edhe më të gjallë në veprimtarinë e saj është fakti se shërben edhe si bibliotekë universitare për studentët, duke siguruar salla të shumta leximi.

Ndryshe nga Shqipëria, Biblioteka Kombëtare e Kosovës që prej vitit 2005, përveç katalogut manual me renditje të alfabetit, përdor edhe katalogun digjital për gjetjen e titujve dhe librave të ndryshëm.

Website i Bilbiotekës Kombëtare të Kosovës është më i aksesueshëm dhe me një dizajn që të fton në të gjitha informacionet e kategorizuara.

Me posht gjeni disa nga objektet e Bilbotekave kombetare ne rajon.



Biloteka Kombetare Kosove



Biloteka Kombetare Mali i Zi



Biloteka Kombetare Serbi



Biloteka Kombetare Kroaci

GJETJET KRYESORE:



1. Biblioteka Kombëtare, është një nga institucionet më të rëndësishme kulturore, identitare të një kombi, por deri më tani është lënë në harresën politike për t'u kujtuar vetëm në përvjetore të themelimit të saj apo sa herë ndryshohen postet drejtuese në institucion dhe politikë.



2. Mungesa e vazhdueshme e investimeve në rikonstruksionin e saj apo në mirëmbajtjen e ambienteve ka bërë që godina e Bibliotekës të përballet me zjarre dhe përmbytje që kanë shkaktuar dëme materiale dhe financiare. Zjarri i vitit 2017 shkaktoi djegien e 3308 njësive bibliotekare, të cilat në total përbëjnë një dëm monetar prej 1.265.200 lek. Ndërsa përmbytja e vitit 2018 solli dëmtimin e 12 mijë librave, revistave dhe gazetave.



3. Përgjatë tre viteve të fundit, pjesën dërmuese të procedurave të prokurimit të shpallura dhe të nënshkruara nga ky institucion e zë sigurimi dhe ruajta e dy godinave të Bibliotekës, asaj qendrore dhe aneksit të quajtur Fondi i Bibliotekës Kombëtare.



4. Në katër vitet e fundit buxheti i akorduar për Bibliotekën Kombëtare ka qenë i njëjtë për të katërta vitet, me disa luhatje të lehta. Ajo çka vihet re nga shpenzimet dhe zërat e akorduar është fakti se pjesën më të madhe të shpenzimeve në buxhet e zenë pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.



5. Për shkak të ngjarjeve të ndodhura vitet e fundit, si zjarri dhe përmbytja, është futur në buxhet zëri për rikonstruksion dhe blerjen e pajisjeve për sinjalizim të zjarrit, veprime këto të marra pas dëmit.



6. Përpos nevojës imediate për të pasur një Bibliotekë të re Kombëtare, kjo nevojë qendron akoma një "fjalë konferencash dhe daljesh publike" të drejtuesve të institucioneve përgjegjëse, pa pasur akoma një projekt konkret dhe një kohë të afërt.




7. E vetmja mënyrë për të pasur mundësi të frekuentosh Bibliotekën Kombëtare është përmes faqes së saj web, teksa ka nisur digjitalizimi i pasurive të saj, por akoma niveli i digjitalizimit është i ulët.

REKOMANDIME:



1. Ndërtimi i bibliotekave të reja të qytetit të Tiranës do të lehtësonte "mpirjen" e Bibliotekës Kombëtare, deri në ndërtimin e saj në një godinë të re.



2. Përmes një studimi të mirëfilltë të nevojave dhe kërkesave të Bibliotekës Kombëtare, Ministria e Kulturës duhet të përcaktojë më shumë fonde në projekte kulturore dhe mirëmbajtje të pasurive bibliotekare se sa harxhon për staf dhe shpenzime operative.



3. Nëse do të ishin marrë masat e nevojshme dhe do të ishte investuar në infrastrukturën e godinës ekzistuese, do të mund të ishte shmangur zjarri i rënë në vitin 2017 dhe përmbytja e vitit 2018. Marrja e masave paraprake dhe zbatimi brenda parametrave të tyre do të parandalojë rreziqet që i kanosen në të ardhmen godinës që ndodhet në gjendje të degraduar.



4. Digjitalizimi, si forma më e mirë e aksesit në informacionet bibliotekare duhet të jetë përparësi e Bibliotekës Kombëtare, me qëllim përmbylljen e tyre në një afat kohor më të shkurtër.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE